

Detajet e kontaktit

Ju mund kontaktoni
Shërbimin e Informacionit për Familjet në
Suffolk në:

Telefoni:

0345 60 800 33

(numër me tarifa lokale)

Linja e ndihmës është e hapur të hënën deri të
premtën 09.00 deri 17.00, të premtën 09.00
deri 16.30. Jashtë këtij orari ka një shërbim
sekretarie.

Email - Suffolkfis@suffolk.gov.uk

Shkruani tek:

Suffolk Family Information Service
Early Years and Childcare
Suffolk County Council
Endeavour House, 8 Russell Road, Ipswich
IP1 2BX

Detajet tuaja dhe çdo rrethanë personale
do të trajtohen me mirëbesim të plotë.



Shërbimi i Informacionit për Familjet në Suffolk



*Këshilla falas rreth
kujdesit për fëmijët
dhe shërbime të tjera
që mbështesin
prindërit*

0345 60 800 33

www.suffolk.gov.uk/family

Çfarë është Shërbimi i Informacionit për Familjet?

Shërbimi Informativ për Familjet Suffolk (FIS) ofron këshilla falas, të paanshme për kujdesin ndaj fëmijëve dhe shërbimet e tjera që mbështesin prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve dhe të rinjve nga moshë 0-19 vjeç deri në moshën 25 vjeç për fëmijët me SEND (Nevoja të Veçanta Arsimore dhe Aftësi të Kufizuara).

Ne ofrojmë ndihmë shtesë për familjet që po mundohen për të gjetur një vend për kujdesjeje.

Ne mund t'ju ndihmojmë të kërkontë për kujdesin ndaj fëmijëve në Numërorin tonë telefonik të Familjeve dhe Komunitetit, i cili përfshin të gjithë ofruesit e kujdesit të fëmijëve të regjistruar me Ofsted-in në Suffolk, ne ofrojmë edhe këshilla përmes telefonit, emailit ose tekstit. Ne punojmë ngushtë me prindërit, ofruesit e kujdesit të fëmijëve dhe profesionistët që mbështesin familjet.

Kujdes fëmijësh për të gjithë

Ne kemi të dhëna të ofruesve të regjistruar me Ofsted-in për fëmijët e moshës 0-14 vjeç si për shembull:

- Kujdestarë fëmijësh
- Kopshte ditore
- Grupe loje parashkollore
- Kopshte private
- Kujdes për fëmijët jashtë orarit të shkollës (klube mëngjesi dhe pas-shkolle)
- Skema loje gjatë pushimeve

Ne ofrojmë këshilla se si të zgjidhni kujdesi për fëmijët që plotëson nevojat tuaja edhe të fëmijës tuaj. Kjo mund të sigurohet në një listë të detajuar të ofruesve të kujdesit për fëmijët në zonën tuaj, e cila përfshin këto informacione:

- Emrin dhe të dhënat e kontaktit të ofruesve të kujdesit për fëmijët
- Llojin e kujdesit të ofruar për fëmijët
- Moshat për të cilat ofrohet shërbimi
- Orari i hapjes
- Nivelin e inspektimit të Ofsted (të tilla si Mirë ose Shkëlqyeshëm).

Edukimi Fillestar i Financuar për 2, 3 dhe 4 vjeçarët

Ne ofrojmë informacione dhe këshilla rreth arsimit të hershëm të financuar për 3 vjeçarët dhe 4 vjeçarët dhe atyre të moshës 2 vjeçare që kualifikohen.

Ne mund t'ju informojmë kur 3 vjeçarja/i juaj ka të drejtën e kujdesit të financuar dhe t'ju shpjegojmë se si të kontrolloni në internet nëse 2 vjeçarja/i juaj ka të drejtë për kujdesin e fëmijëve pa pagesë.

Numërori telefonik i Shërbimeve për Familjet

Faqja jonë në internet e Numërorit telefonik të Shërbimeve për Familjet i lejon prindërit të kërkojnë shërbime të kujdesit. Faqja jonë e internetit është falas, nuk duhet të regjistroheni.

Këtu mund të gjeni informacion mbi:

- Ofruesit e kujdesit për fëmijët (çerdhet ditore, grupe loje parashkollore, kujdestarë fëmijësh pas shkolle)
- Qendrat e Shëndetit dhe Fëmijëve
- Klasa mbi prindërimin
- Grupet e Fëmijëve dhe Prindërve
- Klubet për të rinjtë
- Aktivitete argëtimi për juve dhe fëmijën tuaj
- Organizatat që mbështesin fëmijët dhe të rinjtë me SEND (Nevoja të Veçanta Arsimore dhe Aftësi të Kufizuara)
- Shërbimet mbështetëse për gjendjen emocionale dhe shëndetin mendor

Vizitoni: www.suffolk.gov.uk/fsd dhe kërkontë sipas fjalëve ose duke përdorur kodin tuaj të plotë për të gjetur kujdesin e fëmijëve zonën tuaj.

